




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



**Drejtoria për Zhvillim Rural**

## **THIRRJE PËR APLIKIM**

**Ftohen të gjithë fermerët e Komunës së Prishtinës që të aplikojnë për përkrahje me mekanizëm bujqësor.**

### **1. Furnizimi me Mikser për ushqim voluminoz të kafshëve**

#### **Kriteret e përgjithshme:**

- Të kenë 7 e më shumë krerë gjedhe;
- Gjedhet duhet të jenë të matrikuara;
- Përfituesi duhet jetë banor rezident i Komunës së Prishtinës dhe objekti (stalla) për vendosjen e gjedheve të jetë në territorin e komunës;
- Nuk kanë të drejtë përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët kanë përfituar në 5 (pesë) vitet e fundit pajisje për përgatitjen (përzierjen) e ushqimit të kafshëve - mikser nga komuna dhe donatorët në bashkëpunim me komunën;
- Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
- Fermerët të cilët nuk kanë pronën në pronësi familjare apo shfrytëzojnë toka me qira, duhet të kenë marrëveshje kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët (të noterizuar) në kohëzgjatje prej 5 viteve;
- Infrastruktura përcjellëse (mekanizëm përkatës për përdorimin e kësaj pajisje bujqësore - traktor);
- Sipërfaqja minimale e tokës bujqësore të punuar duhet të jetë minimum 1 ha;
- Fermeri ka të drejtë të aplikojë vetëm për një pajisje.

#### **Kriteret specifike:**

- Fermerët që kanë numër më të madh të krerëve të gjedheve, kanë përparësi në raport me ata që kanë numër më të vogël të gjedheve;
- Përparësi kanë fermerët të cilët nuk kanë qenë asnjëherë përfitues të kësaj pajisjeje nga komuna dhe donatorët në bashkëpunim me komunën;
- Njohuri elementare në fushën përkatëse;

- Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme bujqësore, fakulteti përkatës);
- Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
- Gratë fermerë dhe grupet e marginalizuara;
- Madhësia e fermës (sipërfaqja e tokës së punuar);
- Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
- Prona e marrë me qira.

### **Dokumentacioni i nevojshëm:**

- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Kopja e një dokumenti identifikues valid të Republikës së Kosovës;
- Vërtetimi nga shërbimet veterinarë të licencuara nga organet përkatëse;
- Marrëveshja në mes palëve (Kontrata e qirasë);
- Dëshmi për përgatitje profesionale –trajnime;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme në afat deri në 6 (gjashtë) muaj;
- Kopja e planit të sipërfaqes punuese në afat deri në 6 (gjashtë) muaj;
- Deklarata nën betim.

## **2. Furnizimi me Shpërndarëse për pleh të shtallës**

### **Kriteret e përgjithshme:**

- Të kenë 10 e më shumë krerë gjedhe;
- Gjedhet duhet të jenë të matrikuluara;
- Përfituesi duhet jetë banor rezident i Komunës së Prishtinës dhe objekti (stalla) për vendosjen e gjedheve të jetë në territorin e komunës;
- Nuk kanë të drejtë përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët kanë përfituar në 5 (pesë) vitet e fundit pajisje për shpërndarjen e plehut shtazor nga komuna dhe donatorët në bashkëpunim me komunën;
- Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
- Fermerët të cilët nuk kanë pronën në pronësi familjare apo shfrytëzojnë toka me qira, duhet të kenë marrëveshje kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët (të noterizuar) në kohëzgjatje prej 5 viteve;
- Infrastruktura përcjellëse (mekanizëm përkatës për përdorimin e kësaj pajisjeje bujqësore - traktor);
- Fermeri ka të drejtë të aplikojë vetëm për një pajisje.

### **Kriteret specifike:**

- Fermerët që kanë numër më të madh të krerëve të gjedheve, kanë përparësi në raport me ata që kanë numër më të vogël të gjedheve;
- Përparësi kanë fermerët të cilët nuk kanë qenë asnjëherë përfitues të kësaj pajisjeje nga komuna dhe donatorët në bashkëpunim me komunën;

- Njohuri elementare në fushën përkatëse;
- Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme bujqësore, fakulteti përkatës);
- Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
- Gratë fermerë dhe grupet e marginalizuara;
- Madhësia e fermës (sipërfaqja e tokës punuese);
- Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
- Prona e marrë me qira.

### **Dokumentacioni i nevojshëm:**

- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Kopja e një dokumenti identifikues valid të Republikës së Kosovës;
- Vërtetimi nga shërbimet veterinarë të licencuara nga organet përkatëse;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme në afat deri në 6 (gjashtë) muaj;
- Kopja e planit të sipërfaqes punuese në afat deri në 6 (gjashtë) muaj;
- Marrëveshja në mes palëve (kontrata e qirasë);
- Dëshmi për përgatitje profesionale – trajnime;
- Deklarata nën betim.

### **3. Furnizimi me freza për traktor**

#### **Kriteret e përgjithshme:**

- Përkrahen fermerët të cilët kultivojnë kultura bujqësore në sipërfaqe minimum 1 ha;
- Përfituesi duhet jetë banor rezident i Komunës së Prishtinës dhe toka e punuar të jetë në territorin e komunës;
- Nuk kanë të drejtë përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët kanë përfituar në 5 (pesë) vitet e fundit pajisje për punimin e tokës (freza) nga komuna dhe donatorët në bashkëpunim me komunën;
- Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
- Fermerët të cilët nuk kanë pronën në pronësi familjare apo shfrytëzojnë toka me qira, duhet të kenë marrëveshje kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët (të noterizuar) në kohëzgjatje prej 5 viteve;
- Infrastruktura përcjellëse (mekanizëm përkatës për përdorimin e kësaj pajisjeje bujqësore - traktor);
- Fermeri ka të drejtë të aplikojë vetëm për një pajisje.

#### **Kriteret specifike:**

- Fermerët që kanë sipërfaqe më të madhe, kanë përparësi në raport me ata që kanë sipërfaqe më të vogël të tokës bujqësore të punuar;
- Përparësi kanë fermerët të cilët nuk kanë qenë asnjëherë përfitues të kësaj pajisjeje nga komuna dhe donatorët në bashkëpunim me komunën;

- Njohuri elementare në fushën përkatëse;
- Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme bujqësore, fakulteti përkatës);
- Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
- Gratë fermerë dhe grupet e marginalizuara;
- Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
- Prona e marrë me qira.

#### **Dokumentacioni i nevojshëm:**

- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Kopja e një dokumenti identifikues valid të Republikës së Kosovës;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme në afat deri në 6 (gjashtë) muaj;
- Kopja e planit të sipërfaqes punuese në afat deri në 6 (gjashtë) muaj;
- Dëshmi për përgatitje profesionale – trajnime;
- Marrëveshja në mes palëve (kontrata e qirasë);
- Deklarata nën betim.

#### **4. Furnizimi me makina mbjellëse të grurit**

##### **Kriteret e përgjithshme:**

- Përkrahen fermerët të cilët kultivojnë kulturën e grurit në sipërfaqe minimum 3 ha;
- Përfituesi duhet jetë banor rezident i Komunës së Prishtinës dhe toka e punuar (mbjellur) me grurë duhet të jetë në territorin e Komunës së Prishtinës;
- Nuk kanë të drejtë përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët kanë përfituar në 5 (pesë) vitet e fundit pajisje për mbjelljen e grurit nga komuna, dhe donatorët në bashkëpunim me komunën;
- Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
- Fermerët të cilët nuk kanë pronën në pronësi familjare apo shfrytëzojnë toka me qira, duhet të kenë marrëveshje kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët (të noterizuar) në kohëzgjatje prej 5 viteve;
- Infrastruktura përcjellëse (mekanizëm përkatës për përdorimin e kësaj pajisjeje bujqësore - traktor);
- Fermeri ka të drejtë të aplikojë vetëm për një pajisje.

##### **Kriteret specifike:**

- Fermerët që kanë sipërfaqe më të madhe, kanë përparësi në raport me ata që kanë sipërfaqe më të vogël të tokës bujqësore të punuar, të mbjellë me grurë;
- Përparësi kanë fermerët të cilët nuk kanë qenë asnjëherë përfitues të kësaj pajisjeje nga komuna dhe donatorët në bashkëpunim me komunën;
- Njohuri elementare në fushën përkatëse;

- Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme bujqësore, fakulteti përkatës);
- Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
- Gratë fermerë dhe grupet e marginalizuara;
- Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
- Prona e marrë me qira.

### **Dokumentacioni i nevojshëm:**

- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Kopja e një dokumenti identifikues valid të Republikës së Kosovës;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme në afat deri në 6 (gjashtë) muaj;
- Kopja e planit të sipërfaqes punuese në afat deri në 6 (gjashtë) muaj;
- Dëshmi për përgatitje profesionale – trajnime;
- Marrëveshja në mes palëve (kontrata e qirasë);
- Deklarata nën betim.

## **5. Furnizim me makina mbjellëse të fidanëve perimore**

### **Kriteret e përgjithshme:**

- Përkrahen fermerët të cilët kultivojnë perime në ambiente të hapura dhe të mbyllura - serra, kulturat: spec, domate, tranguj, lakër, presh, sallatë e gjelbër;
- Aplikuesi duhet të ketë pronën (sipërfaqen e mbjellë, serrën apo sipërfaqen në fushë të hapur) në territorin e Komunës së Prishtinës dhe të jetë banor rezident i saj;
- Të kenë të mbjellë 1.00 ha me perime në fushë të hapur ose 0.10 ha në serra;
- Parcela e mbjellë me kulturat bujqësore të lartcekura në fushë të hapur duhet të jetë së paku 0.50 ha e pandarë, ndërsa në serra 0.05 ha;
- Nuk kanë të drejtë përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët kanë përfituar nga komuna dhe donatorët në bashkëpunim me komunën, mekanizëm të njëjtë në 5 (pesë) vitet e fundit;
- Fermerët të cilët nuk e kanë pronën në pronësi familjare, por shfrytëzojnë tokë me qira, duhet të kenë marrëveshjen kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët (të noterizuar), në kohëzgjatje prej tri (5) vitesh;
- Infrastruktura përcjellëse (mekanizëm përkatës për përdorimin e kësaj pajisjeje bujqësore - traktor);
- Fermeri ka të drejtë të aplikojë vetëm për një pajisje.

### **Kriteret specifike:**

- Njohuritë elementare në fushën përkatëse;
- Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme bujqësore, fakulteti përkatës);
- Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;

- Gratë fermere dhe grupet e marginalizuara;
- Madhësia e fermës, do të kenë përparësi aplikuesit të cilët kanë sipërfaqe më të madhe të kultivuar me kultura bujqësore të cekura më lart, në raport me ata me sipërfaqe më të vogël;
- Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
- Prona e marrë me qira;
- Përparësi do të kenë kultivuesit (fermerët) të cilët kanë, ofrojnë dëshmi - kontrata në lidhje me shitjen e produkteve të tyre për vitin paraprak (2023), si dhe të dëshmojnë me faturë të regjistruar ose qarkullim bankar.

### **Dokumentacioni i nevojshëm:**

- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Kopja e një dokumenti identifikues të Republikës së Kosovës;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme në afat deri në 6 (gjashtë) muaj;
- Kopja e planit të sipërfaqes punuese në afat deri në 6 (gjashtë) muaj;
- Dëshmi-kontrata për shitjen e produkteve;
- Marrëveshja në mes palëve (kontrata e qirasë);
- Deklarata nën betim.

## **6. Furnizim me plug dy brazë**

### **Kriteret e përgjithshme:**

- Përkrahen fermerët të cilët kultivojnë kultura bujqësore në sipërfaqe minimum 1.00 ha;
- Parcela duhet të jetë së paku 0.50 ha e pandarë;
- Përfituesi duhet jetë banor rezident i Komunës së Prishtinës dhe toka e punuar (mbjellur) me kultura bujqësore duhet të jetë në territorin e Komunës së Prishtinës;
- Nuk kanë të drejtë përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët kanë përfituar në 5 (pesë) vitet e fundit pajisje plug nga komuna dhe donatorët në bashkëpunim me komunën;
- Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
- Fermerët të cilët nuk kanë pronën në pronësi familjare apo shfrytëzojnë toka me qira, duhet të kenë marrëveshje kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët në kohëzgjatje prej 3 viteve;
- Fermeri duhet të posedojë mekanizëm përkatës për përdorimin e kësaj pajisjeje - traktor;
- Fermeri ka të drejtë të aplikojë vetëm për një pajisje.

### **Kriteret specifike:**

- Fermerët që kanë sipërfaqe më të madhe të kultivuar me kultura bujqësore kanë përparësi në raport me ata që kanë sipërfaqe më të vogël;
- Përparësi kanë fermerët të cilët nuk kanë qenë asnjëherë përfitues të kësaj pajisjeje nga komuna dhe donatorët në bashkëpunim me komunën;
- Njohuri elementare në fushën përkatëse;
- Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme bujqësore, fakulteti përkatës);
- Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
- Gratë fermerë dhe grupet e marginalizuara;
- Madhësia e fermës (sipërfaqja e tokës punuese bujqësore);
- Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
- Prona e marrë me qira.

### **Dokumentacioni i nevojshëm:**

- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Kopja e një dokumenti identifikues valid të Republikës së Kosovës;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme në afat deri në 6 (gjashtë) muaj;
- Kopja e planit të sipërfaqes punuese në afat deri në 6 (gjashtë) muaj;
- Marrëveshja në mes palëve (kontrata e qirasë);
- Dëshmi për përgatitje profesionale –trajnime;
- Deklarata nën betim.

## **7. Furnizim me set për mirëmbajtjen dhe trajtimin e pemishteve (Spërkatëse elektrike 16l, gërshërë të dorës për krasitje, gërshërë me bishta të gjatë për krasitje, gërshërë për shartim, gërshërë aku dhe rroba pune)**

### **Kriteret e përgjithshme:**

- Përkrahen fermerët e të cilët kultivojnë pemë dru-frutore (pemishte);
- Aplikuesi duhet ta ketë pronën (pemishten) në territorin e Komunës së Prishtinës dhe të jetë banor rezident i saj;
- Aplikuesi duhet të ketë sipërfaqe të kultivuar me pemishte (pemë dru-frutore) të rregullt, (e lëvruar ose me bari të kultivuar në mes të rreshtave, krasitur, mbrojtur nga sëmundjet dhe dëmtuesit) dhe sistemi i mbjelljes të jetë me renditje të qartë dhe të rregullt të rendeve/rreshtave në sipërfaqe minimale 0.20 ha dhe maksimale 1 ha.
- Parcela e mbjellë me pemë dru-frutore (pemishte) duhet të jetë së paku 0.20 ha e pandarë;
- Nuk kanë të drejtë përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët kanë përfituar pajisje të njëjta nga komuna ose donatorët në bashkëpunim me komunën në 5 (pesë) vitet e fundit;
- Nuk mund të jenë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;

- Fermerët të cilët nuk e kanë pronën në pronësi familjare, por shfrytëzojnë toka më qira, duhet të kenë marrëveshjen kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët, në kohëzgjatje për dhjetë (10) vjet;
- Fermeri ka të drejtë të aplikojë vetëm për një pajisje.

### **Kriteret specifike:**

- Fermerët me sipërfaqe më të madhe kanë përparësi në raport me ata që kanë sipërfaqe më të vogël të punuar;
- Të kenë njohuri elementare në fushën përkatëse;
- Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme - bujqësore, fakulteti përkatës);
- Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
- Gratë fermere dhe grupet e marginalizuara;
- Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
- Prona e marrë me qira.

### **Dokumentacioni i nevojshëm:**

- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Kopja e një dokumenti identifikues të Republikës së Kosovës;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme, në afat deri në 6 (gjashtë) muaj;
- Kopja e planit të sipërfaqes punuese (pemishtes) në afat deri në 6 (gjashtë) muaj;
- Dëshmi për përgatitje profesionale – trajnime;
- Marrëveshja në mes palëve (kontrata e qirasë).
- Deklarata nën betim.

**Afati për aplikim është nga 22.04.2024 deri më 10.05.2024.**

**Aplikimi bëhet në zyrat e Drejtorisë së Bujqësisë, në objektin e Komunës së Vjetër, kati përdhësë.**

### **VËREJTJE**

Nëse komisioni parasheh të nevojshme sjelljen e dokumenteve shtesë, të cilat mundësojnë zgjedhjen e përfituesit, qytetari (fermeri) është i obliguar që t'i sjellë ato në afatin i cili i caktohet, në të kundërtën humb të drejtën për të qenë përfitues i grantit.